

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6496
E premte, 24 dhjetor 2021
çmimi 0.40 €

Specialja injoron sërish
garancinë e policisë, u
vazhdohet paraburgimi
Gucatit dhe Haradinajt

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA NË TERR

Rëndohet gjendja me energji elektrike

FAQE 4-5



Në 24 orët e fundit është rënduar gjendja e furnizimit me energji elektrike në vend. Gjatë kësaj kohe qytetarët e Kosovës janë përballur me shkurtime më të gjata sesa ishin paralajmëruar nga KEDS-i. Në disa vende është raportuar për mungesë të rrymës deri në gjashtë orë. Ndërprerjet e gjata të energjisë elektrike u kanë sjellë dëme shumë bizneseve. Për krizën e krijuar opozita e ka fajësuar qeverinë, ndërsa kjo e fundit i ka fajësuar qeveritë e mëhershme

AKTUALE



REGJISTRIMI I POPULLSISË
SË KOSOVËS DO TË BËHET
NË VITIN 2022 F. 5

MINISTRI LATIFI KËRKON ZBATIMIN
E MASAVE KUNDËR COVIDIT F. 6

MIRATOHET PROJEKTLIGJI
PËR INSPEKTIMET, OPOZITA
E KUNDËRSHTON F. 7

ANTIGONA BERISHA-BYTYQI
ZGJEDHET KRYESUESE E
KUVENDIT KOMUNAL TË PRIZRENIT F. 7

EKONOMI

ZKA-ja GJEN PROJEKTE
NË KOMUNA QË KANË FILLUAR
NË VITIN 2013 DHE S'KANË
PËRFUNDUAR ENDE F. 8

REFORMA NË FISKALIZIM E
PROPOZUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE MUND TA KTHEJË
GJITHË PROCESIN NË PIKËN ZERO F. 8

SPORT




EJU: NORA NË TOKIO ARRITI
POTENCIALIN PËR T'U BËRË
KAMPIONE OLIMPIKE F. 10

PRESIDENTI I KROACISË, ZORAN MILLANOVIQ, VIZITON REPUBLIKËN E KOSOVËS

PRESIDENTI KROAT: 'BALLKANI I HAPUR' PA KOSOVËN ËSHTË 'PALIDHJE'

Presidenti i Kroacisë, Zoran Millanović, gjatë vizitës në Prishtinë, ka thënë se "Ballkani i hapur" pa Kosovën është një projekt "palidhje". Ai në një konferencë të përbashkët me presidenten Vjosa Osmani ka thënë se Kosova është shtet funksional dhe me demokraci të gjallë. "Nëse kjo iniciativë nuk e mbulon Kosovën në mënyrë të barabartë atëherë është, kushtimisht thënë, palidhje", ka thënë presidenti kroat

FAQE 4-5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@ml.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mbr: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Berlini zgjedh gruan e parë në krye të Bashkisë

BERLIN, 23 DHJETOR - Socialdemokratja Franziska Giffey, ish-ministrja gjermane e Familjes, është gruaja e parë që ka marrë postin e kryebashkiakes së Berlinit pas votimit nga delegatët e qytetit. Franziska Giffey është betuar para Parlamentit të Berlinit pasi është zgjedhur në Dhomën e Përfaqësuesve. Vendimi e bën udhëheqësen rajonale të Social Demokratëve (SPD) në Berlin, kryetaren e parë grua të qytetit. Kryetari i Senatit, Dennis Buchner, ka bërë me dije se 84 deputetë kanë votuar për Giffeyt, ndërsa 52 kanë votuar kundër dhe dy kanë abstenuar. Giffey, e cila ka shërbyer si ministre e Familjes deri në dorëheqjen e saj në maj të këtij viti, kishte nevojë për të paktën 74 vota për t'u zgjedhur. Tashmë ajo kryeson qeverinë e landit të kryeqytetit gjerman, e cila

përbëhet nga një koalicion mes SPD-së, të Gjellbërve dhe Partisë së Majtë, koalicion që së bashku ka 92 deputetë. Giffey ka dhënë dorëheqje nga qeveria e fundit e ish-kancelares Angela Merkel, pas akuzave për plagjiaturë në tezën e saj të doktoraturës. Më vonë asaj i është hequr doktoratura. Përpara se t'i bashkohej qeverisë kombëtare në vitin 2018, Giffey ishte më së shumti e njohur si kryebashkiake e qarkut Neukölln në Berlin.

Strehimi, prioriteti kryesor

Në detyrën e saj të re, Giffey ka identifikuar si prioritet kryesor çështjen e strehimit. Rritja e çmimit të qirave në Berlin është një nga temat më të debatuar. Qeveria e Giffey do të duhet të vendosë se si të veprojnë në lidhje me rezultatin e një referendumi

jodetyrues në shtator, në të cilin votuesit mbështetën idenë që qyteti të shpronësojë rreth 240 000 apartamente nga pronarët e korporatave. Rreth 56 për qind e atyre që votuan ishin në favor të marrjes së masave kundër kompanive të pasurive të paluajtshme, që menaxhojnë më shumë se 3 000 prona. Giffey është shprehur fuqishëm kundër shpronësimit. Vendimi, i votuar të shtunën (18.12) nga delegatët në një konferencë të partisë në pushtet, e vë SPD-në kundër dy partnerëve të saj të vegjël të koalicionit në qeverinë e Berlinit, raporton "DW".

Të tria palët kanë nënshkruar një udhërrëfyes, duke bërë thirrje për një "partneritet publik privat për ndërtime të reja dhe strehim të përballueshëm". Ndërsa Giffey është gruaja e parë që zgjidhet kryetare bashkie e Berlinit, Louise Schroeder e SPD-së e ka ushtruar



detyrën e kryetares së bashkisë nga maji 1947 deri në dhjetor 1948. Schroeder kishte qenë më herët nënkryetare e bashkisë dhe

ishite emëruar në detyrë pasi paraardhësi i saj dha dorëheqje menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore.

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miraton dorëheqjen e Zaevit

SHKUP, 23 DHJETOR - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka miratuar të enjten dorëheqjen e kryeministrit Zoran Zaev, e cila është pritur me duartrokitje nga VMRO DPMNE-ja opozitare. Dorëheqja e kreut të qeverisë është konstatuar pa debat në seancën e Kuvendit, pasi këtë e ka kërkuar Zaevi në arsyetimin me shkrim të dorëheqjes. Zaevi dorëheqjen nga qeveria e ka paralajmëruar më 31 tetor, pas disfatës së thellë të Lidhjes Social-Demokrate (LSDM) në zgjedhjet lokale. Ai ka marrë përgjegjësinë për humbjen nga VMRO DPMNE-ja duke dhënë dorëheqje edhe nga drejtimi i



partisë. "Dëshiroj të jap shembull për t'i njohur vendimet e virtytshme kur është

e nevojshme dhe për të dhënë një kontribut tjetër për forcimin e kapaciteteve demokratike të

popullit, por edhe liderëve të ardhshëm që të jenë të vetëdijshëm për detyrën e tyre qytetare kur kujdesen për vendin e tyre", ka shkruar Zaev në arsyetimin e aktit të dorëheqjes. Pas konstatimit të dorëheqjes, kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi, e ka njoftuar presidentin Stevo Pendarovski, i cili në afat prej dhjetë ditëve duhet ta caktojë mandatarin e ri për kryeministër të Maqedonisë së Veriut. Ai do të jetë Dimitar Kovačevski, kryetar i Lidhjes Socialdemokrate, pasi paraprakisht ka njoftuar se ka shumicën parlamentare në Kuvend. Pjesë e qeverisë së re, përveç

LSDM-së dhe Bashkimit Demokratik për Integritet, do të jetë edhe partia Alternativa, e cila zëvendëson Lëvizjen Besa që pas zgjedhjeve lokale u largua nga qeveria. Shumica e re parlamentare ka 64 deputetë nga 120 sa numëron Kuvendi i Maqedonisë së Veriut. Mandatarin, sipas Kushtetutës, brenda 20 ditëve duhet të dorëzojë për miratim në Kuvend përbërjen e re qeveritare, e cila votohet me 61 vota të deputetëve. Qeveria e re, bazuar në afatet kushtetuese, duhet të zgjidhet më së voni deri në mesin e muajit janar të vitit 2022.

Rusia thotë se nuk ka plane për pushtimin e Ukrainës

MOSKË, 23 DHJETOR - Rusia nuk po përgatit pushtim ushtarak të Ukrainës, ka thënë ambasadori rus në Bashkimin Evropian, teksa diplomatët kryesorë pritët të takohen në fillim të vitit të ardhshëm për të diskutuar lidhur me propozimet e sigurisë të paraqitura nga Moska. Ambasadori rus në BE, Vladimir Chizhov, ka thënë se Rusia dëshiron që t'i mbështesë popujt rusishtfolës që jetojnë në shtete të tjera, por ai shtoi se Moska asnjëherë nuk ka thënë se do të

përdorë ushtrinë për ta arritur këtë qëllim. "Rusia nuk po planifikon ta sulmojë asnjë shtet. Mund t'ju siguroj se asnjë ushtar rus nuk është duke u përgatitur për ta pushtuar Ukrainën", ka thënë Chizhov në një intervistë për gazetën gjermane "Die Welt". Kremli ka grumbulluar rreth 100 mijë trupa në afërsi të kufirit të Ukrainës, duke rritur shqetësimet e Shteteve të Bashkuara, Kievit, NATO-s dhe vendeve evropiane. Më herët Rusia kishte hedhur poshtë këto

shqetësime të Perëndimit, duke argumentuar se ajo është e lirë që t'i vendosë trupat e saj ku të dojë brenda territorit rus. Më 22 dhjetor ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, ka thënë se negociatorët rusë dhe amerikanë do të takohen në fillim të vitit të ardhshëm për të diskutuar lidhur me propozimet e sigurisë së Moskës, ku përfshihet kërkesa për ndalimin e zgjerimit të NATO-s nga Lindja dhe kufizime për aktivitetet ushtarake të Aleancës në Evropën Lindore.





PRESIDENTI I KROACISË, ZORAN MILLANOVIQ, VIZITON REPUBLIKËN E KOSOVËS

PRESIDENTI KROAT: 'BALLKANI I HAPUR' PA KOSOVËN ËSHTË 'PALIDHJE'

Presidenti i Kroacisë, Zoran Millanoviç, gjatë vizitës në Prishtinë, ka thënë se "Ballkani i hapur" pa Kosovën është një projekt "palidhje". Ai në një konferencë të përbashkët me presidenten Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova është shtet funksional dhe me demokraci të gjallë. "Nëse kjo iniciativë nuk e mbulon Kosovën në mënyrë të barabartë, atëherë është, kushtimisht thënë, palidhje", ka thënë presidenti kroat

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten me nderimet më të larta shtetërore në vizitë zyrtare presidentin e Republikës së Kroacisë, Zoran Milanoviç. Osmani dhe presidenti Milanoviç, pas takimit në Presidencë, kanë mbajtur konferencë për medie. Me këtë rast, presidentja Osmani ka thënë se Kroacia është një ndër shtetet që ka qëndruar pranë Kosovës në çastet më të vështira, por edhe sot. "Për këtë përkrahje jashtëzakonisht të madhe populli i Republikës së Kosovës i është jashtëzakonisht

mirënjohës Republikës së Kroacisë dhe, po ashtu, e falënderoj edhe vetë presidentin Milanoviç për përkrahjen e tij personale që Kosova të ecë përpara si shtet i pavarur, sovran dhe shtet i zhvilluar dhe i barabartë në mesin e kombeve të



lira", ka thënë Osmani. E para e vendit ka shtuar se Republika e Kosovës dhe Republika e Kroacisë kanë marrëdhënie të shkëlqyeshme. "Kroacinë vërtet e konsiderojmë aleat kyç. Marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve ndërtohen mbi lidhje të forta të miqësisë që ekzistojnë historikisht ndërmjet dy kombeve tona. Miqësia dhe solidariteti natyrisht se datojnë qysh në vitet '90, kur të dyja kombet u ekspozuan ndaj luftërave të tmerrshme", ka theksuar ajo.

Presidentja Osmani ka thënë se është e lumtur që qytetarët kroatë me origjinë shqiptarë janë integruar mirë dhe ndihen qytetarë krenarë të Republikës së Kroacisë. "Do të bëjmë gjithçka që është brenda kapaciteteve tona për t'i adresuar nevojat e të gjitha komuniteteve, përfshirë komunitetin kroat, në mënyrë që ata të prosperojnë e të ecin përpara në shtetin e tyre, në Republikën e Kosovës" ka pohuar Osmani, duke shtuar Kosova ka vizion të qartë, atë të integritetit në strukturat euroatlantike. "Natyrisht që ne asnjëherë nuk kemi shikuar diku tjetër. Prandaj, edhe ndihmën dhe përkrahjen e Kroacisë në këtë drejtim e vlerësojmë shumë. Në radhë të parë sepse si shtet i rajonit tonë tashmë është anëtar i Bashkimit Evropian dhe mund të mësojmë shumë nga përvoja e këtij shteti, në radhë të dytë si anëtar i NATO-s e kupton drejt se sa është e rëndësishme që edhe Kosova të jetë aty ku e ka vendin duke kontribuar në paqen dhe stabilitetin në rajon edhe më tej duke u anëtarësuar në NATO", ka theksuar presidentja Osmani.

Kurse duke folur për "Ballkanin e hapur", Osmani ka theksuar se Kosova insiston që bashkëpunimi rajonal të vazhdojë në kornizën e Procesit të Berlinit, nismë kjo e cila, siç ka thënë ajo, ka për qëllim që t'i shtyjë shtetet e Ballkanit

Perëndimor drejt Bashkimit Evropian. "Prandaj Kosova e ka bërë të qartë që alternativa e vetme që e shohim për të ecur drejt strukturave euro-atlantike është duke qenë pjesë e Procesit të Berlinit, ku që nga fillimi ka vlejtur parimi i barazisë dhe parimi i gjithëpërfshirjes. Në momentin që Serbia heq dorë nga tendencat destabilizuese ndaj rajonit, në momentin që Serbia e njeh Kosovën si realitet i pakthyeshem, si realitet që po ecën përpara dhe assesi nuk do të kthehet prapa, atëherë dikush mund ta marrë seriozisht deklaratën e (presidentit të Serbisë, Aleksandër) Vuçiqit se i intereson bashkëpunimi rajonal", ka thënë Osmani.

Ndërsa presidenti i Kroacisë, Zoran Millanoviç, ka thënë se "Ballkani i hapur" pa Kosovën është një projekt "palidhje". Në këtë kontekst, ai ka thënë se Kosova është shtet funksional dhe me demokraci të gjallë. "Kosova është një shtet i dashur për ne dhe për mua, pa qëllimin që ta sfidoj dikë, sepse unë nuk jam këtu që ta sfidoj Beogradin ose dikë të tretë. Por, Kosova është shtet i parashikueshem, ku funksionon një demokraci mjaft vibrante dhe e gjallë", ka thënë Millanoviç, duke shtuar se Kroacia është vend i Bashkimit Evropian dhe se "Ballkani i hapur" nuk e prek në mënyrë të drejtpërdrejtë. "Nëse kjo iniciativë nuk e mbulon Kosovën në mënyrë të barabartë, atëherë është, kushtimisht thënë, palidhje", ka thënë presidenti kroat.

Pas takimit me presidenten Osmani, Millanoviç është takuar edhe me kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti. Në këto takime është biseduar për aktualitetin politik, pandeminë, situatën energjetike, ekonominë, zhvillimet rajonale dhe thellimin e bashkëpunimit ndërshtetëror.



Specialja injoron sërish garancën e policisë, u vazhdohet paraburgimi Gucatit dhe Haradinajt

Hagë, 23 dhjetor - Trupi gjyqësor i Gjykatës Speciale ua vazhduar paraburgimin dy krerëve të OVL-UÇK-së, Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

Vendimi në fjalë është marrë para dy ditësh. Me këtë rast trupi gjyqësor ka kërkuar nga prokuroria që parashtrimet për rishikimin tjetër të paraburgimit t'i

dërgojë deri më 7 shkurt të vitit 2022.

I njëjti urdhër i është dhënë edhe mbrojtjes me afat deri më 14 shkurt.

Policia e Kosovës ka dhënë

garanci për lirimin e krerëve të OVL-UÇK-së së UÇK-së nga paraburgimi, mirëpo edhe këtë herë Specialja ka injoruar këtë institucion.





KOSOVA NË TERR

Rëndohet gjendja me energji elektrike

Në 24 orët e fundit është rënduar gjendja e furnizimit me energji elektrike në vend. Gjatë kësaj kohe qytetarët e Kosovës janë përballur me shkurtime më të gjata sesa që kishte paralajmëruar KEDS-i. Në disa vende është raportuar për mungesë të rrymës deri në gjashtë orë. Ndërprerjet e gjata të energjisë elektrike kanë sjellë dëme për shumë biznese. Për krizën e krijuar opozita e ka fajësuar qeverinë, ndërsa kjo e fundit i ka fajësuar qeveritë e mëhershme

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

Prishtinë, 23 dhjetor - Kriza energjetike në Kosovë është thelluar. Qytetarët e Kosovës të enjten janë përballur me shkurtime të ashpra të mungesës së energjisë elektrike. Ata janë ankuar se shkurtimet kanë zgjatur deri në gjashtë orë, ndonëse paralajmërimi i kompanisë për Distribuim të Energjisë Elektrike (KEDS) ka qenë se ato do të jenë vetëm dy orë në ditë.

Shkurtimet e gjata të energjisë elektrike i ka konfirmuar edhe vetë KEDS-i. Përmes një sqarimi, kjo kompania ka bërë me dije se arsye për këto shkurtime më të gjata janë ngarkesat që po shfaqen në dalje gjatë këtij procesi. "Duke qenë se kriza energjetike tashmë është thelluar në vendin tonë, dhe nga

ana tjetër faktorë të tjerë, sikurse mbingarkesat e sistemit elektro-energjetik dhe trendi i rritjes së shpejtë të konsumit, kanë bërë që kufizimet e planifikuara me energji elektrike për të gjithë konsumatorët të vazhdojnë edhe në ditët në vijim, derisa të marrim instruksione të tjera nga KOSTT-i. Këto ndalesa sipas planit do të vazhdojnë të jenë rreth dy orë për secilin grup të konsumatorëve në periudha të ndryshme të ditës. Dukuri që po pengon kycjen me kohë të grupeve të caktuara, janë ngarkesat e mëdha që po shfaqen në dalje gjatë këtij procesi", është thënë në njoftimin e KEDS-it.

Për ta eliminuar këtë dukuri kompania ka kërkuar bashkëpunim nga të gjithë. "Konsumatorët të cilët janë pa energji elektrike, sipas planit të kufizimeve, duhet që pajisjet

elektrike mundësisht t'i kenë të shkyçura apo të larguara nga priza, në mënyrë që procesi i rikyçjes të secilës dalje të realizohet në mënyrë të suksesshme. Informimi i konsumatorëve për këto kufizime të planifikuara është duke u bërë përmes aplikacionit 'eKesco' për konsumatorët të cilët kanë llogari të hapur në këtë aplikacion. Po ashtu, në uebfaqe të KEDS-it, përmes hartës, konsumatorët mund t'i shohin kufizimet e planifikuara që do të ndodhin në pikën matëse të saj/tij apo të lagjes ku jeton. Po ashtu, edhe mediet do të njoftohen për planin e kufizimeve, pasi këto plane t'i pranojmë nga KOSTT", ka vlerësuar KEDS-i.

Përveç qytetarëve, mungesën e madhe të rrymës e kanë konfirmuar edhe zyrtarët e lartë politikë.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Mefail Bajqinovci, ka bërë me dije se në disa lagje të kryeqytetit rryma është ndalur deri gjashtë në orë. "Në disa lagje rryma ndalet deri në gjashtë orë në ditë, ndërsa kemi lagje ku energjia nuk ndalet fare. KEDS-i nuk guxon t'i privilegjojë lagjet e caktuara me energji elektrike, ndërsa lagjet në periferi t'i diskriminojë, duke i lënë në terr

me orë të tëra", ka shkruar ai në profilin e vet në "Facebook".

Opozita fajëson qeverinë për krizën

Përfaqësuesi e opozitës e kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës për gjendjen e rënduar. Sipas tyre, qeveria nuk është treguar vizionare për shmangien e kësaj krize. Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se qeveria e Kurtit e ka rikthyer vendin në vitin 2000. "Deri në fund të këtij viti qeveria plebishitare na solli në vitin 2000. Pa rrymë e me agregatë. Por... nuk është ftohtë, po nxehehi me votat e mbi 51 për qind të qytetarëve! Kështu e ka referendumi. Të mërdhinë, por duhet të thuash që është mirë, sepse populli kështu ka vendosur", ka shkruar Mustafa në profilin e tij në "Facebook".

Kurse kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, në llogarinë e vet në "Facebook", ia ka shtruar disa pyetjet kryeministri Kurti. "Ku i kishte mendtë Kurti e VV-ja kur e kundërshtonte me forcë investimin 1.2 miliard dollarë për 500 megavatë energji, të çmimit deri në 86 euro për megavat, investim që do të hapte vende të punës dhe do ta

kthente Kosovën në fuqi rajonale të energjisë? Ku i kishte mendtë Kurti e VV-ja kur e refuzuan investimin amerikan, 200 milionë dollarë falas, të aprovuara nga Presidenti Biden për gazsjellësin Shkup - Prishtinë?", ka shkruar Haradinaj.

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka kërkuar që të ndalen menjëherë shkurtimet e energjisë elektrike në Kosovë. "Reduktimet e energjisë elektrike janë të padurueshme dhe të papranueshme. KEDS po gënjen! Nuk janë 2 orë në ditë reduktimet. Ka lagje në Prishtinë e fshatra gjithandej Kosovës ku rryma është ndalur për 6 orë rresht. Operatori privat e ka detyrim kontraktual furnizimin me energji elektrike. Nëse kjo nuk ndodh, është Qeveria që duhet të ndërhyjë. Qeveria 'Krejt dhe Drejt!' është bërë Qeveri 'shumë vota për asgjë'. Qeveria nuk po guxon t'iu dalë përballë privatizuesve. Ka ndarë para të gatshme për ta, por prapë nuk kemi rrymë. Aksioni dhe organizimet do të rritën, do të vazhdojnë. Të gjithë që kanë preokupim këtë padrejtësi i ftojme në mosdëgjueshmëri qytetare. Ajo që sot na bashkon, pa dallim, është terri ku na ka futur kjo qeveri", ka shkruar

Regjistrimi i popullsisë së Kosovës do të bëhet në vitin 2022

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Qeveria e Kosovës ka miratuar Projektligjin për regjistrimin ekonomik familjare dhe banesave. Në mbledhjen e qeverisë është bërë me dije se regjistrimi i popullsisë së Kosovës do të bëhet në vitin 2022. Sipas kryeministrit Albin Kurti, ky projektligj do të zhvillohet në vitin 2022 dhe do të ndihmojë në përcaktimin e kompetencave të organeve të cilat rregullojnë dhe zbatojnë procesin e regjistrimit të popullsisë. Propozimin e këtij

projektligji para kabinetit qeveritar e ka bërë ministri i Financave, Hekuran Murati. “Regjistrimi i popullsisë është bërë në vitin 2011 dhe normalisht do të duhej të bëhej në vitin 2021, por për shkak të pandemisë dhe të rrëzimit të qeverisë, regjistrimi do të bëhet në vitin 2022”, ka thënë Murati. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2018 numri i banorëve rezidentë në Kosovë ishte rreth 1.8 milion.



Molliqaj në llogarinë e vet në “Facebook”. Këto kritika i ka mohuar kryeministri Albin Kurti. Në mbledhje të qeverisë, ai ka thënë se ata që kërkojnë llogari nga qeveria duhet ta shohin veten në pasqyrë. “Ndonëse ndodhemi në një krizë të vështirë energjetike, po bëjmë gjithë çfarë mundemi e krejt çka dimë që të dalim me sa më pak humbje e dëme prej saj, ndërkaq ata që për dështimet e tyre për dekada kërkojnë llogari nga ne që sot shënojmë 9 muaj në qeveri, duhet më parë ta shohin

veten në pasqyrë. Zëri i tyre i lartë i propagandës nuk duhet ta turbullojë zërin tonë të arsyes”, ka thënë Kurti.

Kërkohet zgjidhje

Klubi i Prodhuesve ka kërkuar zgjidhje të problemeve me energji elektrike. Përmes një reagimi, ky klub ka vlerësuar se mungesa e rrymës po sjell dëme jashtëzakonisht të mëdha te prodhuesit vendorë. “Klubi i Prodhuesve i Kosovës shpreh kundërshtimin e thellë kundrejt problemeve dhe situatës së

krijuar me furnizim të energjisë elektrike.

Kriza elektroenergetike nëpër të cilën jemi duke kaluar është duke shkaktuar dëme jashtëzakonisht të mëdha te prodhuesit vendorë. Prodhuesit që një kohë janë duke u përballur me furnizim jo të rregullt të energjisë, mirëpo ndërprerjet e shpeshta dhe të tejjgjatura i bëjnë kompanitë vendore të kenë humbje të konsiderueshme”, ka vlerësuar ky klub.

Sipas njoftimit, prodhuesit vendorë janë duke operuar me kosto ekstreme të prodhimit, ku

janë të detyruar që të furnizohen me energji nga gjeneratorët. “Kjo gjendje jo vetëm që rrit shpenzimet dhe koston e produkteve, por rrezikon edhe humbjen e vendeve të punës. Prandaj, kërkojmë nga institucionet vendore që ta kenë parasysh gjendjen e brishtë të prodhuesve vendorë dhe të ofrojnë zgjidhje që sektori i prodhimit të mos përfshihet në reduktimet e energjisë elektrike. Po ashtu, duhet të kemi parasysh që bizneset një kohë të gjatë janë duke e ruajtur paqen sociale, ku edhe paguajnë tarifa shumë më

të larta se konsumuesit familjarë. Ndërprerja e energjisë nuk është zgjidhje. Ajo vetëm sa po vështirëson rrethanat dhe kushtet e sektorit të prodhimit, prandaj duhet të gjenden alternativa të tjera të cilat mundësojnë vazhdimin e punës për bizneset vendore” është thënë në njoftimin e këtij klubi. Rritja e çmimit në tregjet ndërkombëtare ka prekur edhe Kosovën dhe vendet e rajonit. Qeveria e Kosovës ka ndarë 20 milionë euro për t’i paguar shpenzimet shtesë për import të rrymës.

Haxhiu dhe Nagavci vizituan Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministri e Drejtësisë, Albulena Haxhiu dhe ministria e Arsimit, Arbërie Nagavci, të enjten kanë vizituar Qendrën Korrektuese në Lipjan, me ç'rast janë njoftuar me sfidat dhe zhvillimet e procesit të përgjithshëm të integritetit

dhe rehabilitimit të të miturve në veçanti me procesin edukativ dhe arsimor që zhvillohet në këtë institucion. Ambientet e punës, ambientet rekreative dhe sportive, ishin cak i vizitës për t'u njohur nga afër me kushtet në të cilat zhvillohen këto aktivitete. Të dy ministret shprehën

mbështetjen për aktivitetet që kontribuojnë për rehabilitimin dhe integrimin e tyre, si dhe e përgëzuan stafin për përkushtimin, rritjen dhe avancimin e programeve që zbatohen për të miturit në konflikt me ligjin në institucionet korrektuese në Kosovë.



Ministri Latifi kërkon zbatimin e masave kundër Covidit

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, me bashkëpunëtorë, ka mbajtur të enjten një takim me kryesuesen e bordit drejtues të ShSKUK-së, dr. Agreta Gecaj-Gashi, drejtorin e ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, drejtorët e klinikave të QKUK-së të ndërlidhura me trajtimin e pacientëve me Covid-19 si dhe drejtorët e spitaleve rajonale të cilët ishin të inkuadruar në takim në mënyrë virtuale.

Në këtë takim ministri Latifi ka kërkuar nga drejtuesit e shërbimeve shëndetësore të Kujdesit Tretësor dhe Dytësor që ta ngritin nivelin e lartë të gatishmërisë për t'u ballafaquar me raste të Covid-19 marrë parasysh situatën epidemiologjike në vendet përreth dhe përhapjen në shumë shtete edhe të variantit tjetër "Omicron".

Ministri Latifi e ka përgëzuar personelin shëndetësor për punën e deritanishme, por ka tërhequr vëmendjen se situata

epidemiologjike në Kosovë aktualisht është e qetë, por mund të përmbysset nëse nuk zbatohen në fuqi masat ekzistuese dhe nëse spitalet nuk janë të mobilizuara maksimalisht për të pritur pacientë në rast të një vale të re të Covid-19.

Gjatë takimit drejtuesit e secilës klinikë të QKUK-së dhe të spitaleve e kanë informuar për kapacitetet aktuale, për mënyrën si i kanë menaxhuar situatat gjatë valëve të kaluara të Covid-19 dhe cilat janë sfidat që i kanë

apo mund t'i kenë në rast të një vale të re. Në këtë takim u tha se furnizimi me pajisje mbrojtëse profesionale dhe barna kundër Covid-19 është i qëndrueshëm, përderisa u kërkuar të forcohet çdo segment me qëllim që sistemi të jetë në gjendje ta përballojë çfarëdo situatë.

Ministri Latifi theksoi se përderisa shtete me sisteme mjaft të fuqishme shëndetësore janë duke ndërmarrë masa mjaft të repta për shkak se Covid-19 i ka vënë në vështirësi, Kosova që ka sistem shëndetësor me

resurse shumë më të kufizuara duhet ta marrë me shumë seriozitet e gatishmëri çdo skenar të mundshëm të zhvillimit të mëtejshëm të situatës epidemiologjike, duke siguruar shërbime për pacientët me Covid-19 dhe atyre me sëmundje të tjera.

Ministri Latifi ka bërë thirrje, gjithashtu, që secili të punojë, qoftë nga pozita e menaxherit, profesionistit apo familjarit, për t'i bindur qytetarët që ende nuk janë vaksinuar kundër Covid-19, për ta bërë sa më parë këtë.



Katër raste të reja me Covid në Kosovë

Prishtinë, 23 dhjetor - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar të enjten se, sipas të dhënave nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, prej 1 983 testeve, katër qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk

është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të enjten janë shëruar edhe pesë qytetarë, ndërsa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 157 988.

Në total numri i rasteve aktive është 321.

Në 24 orët e fundit janë dhënë

2 006 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 661 024 doza të vaksinës.

Deri më sot 779 012 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.



Ministri i Mbrojtjes i jep mirënjohje familjes së Adem Demaçit

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka dhënë mirënjohje për familjen madhështore të simbolit të qëndresës sonë

kombëtare për liri dhe pavarësi, Adem Demaçit. Mehaj ka thënë se familja Demaçi ishte e pamposhtur dhe i qëndroi fuqishëm

betejës së nisur nga Baca Adem dhe bashkërisht rrugëtuan me sfida të mëdha deri në fitoren përfundimtare. "Vigani i

kombit, Adem Demaçi, ishte, është dhe do të jetë frymëzimi ynë i përhershëm", ka shkruar Mehaj.



SBASHK-u, letër Kurtit: Kryeministër, qasja juaj ndaj sindikatave është e gabuar

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 DHJETOR - Sindikata e Bashkuara e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (SBASHK) i është drejtuar kryeministrit Albin Kurti me një letër publike. Në letër të SBASHK-ut, drejtuar Kurtit, thuhet se kanë kuptuar nga Komiteti i Sindikatave Evropiane të Arsimit (ETUCE) dhe nga Unioni Evropian i Sindikatave të Shërbimeve Publike (EPSU), se kryeministri i është përgjigjur shkresës së tyre. "Na erdhi keq kur kuptuam se ata janë të indinjuar e shumë të pakënaqur me ato që u ke thënë, prandaj duke parë se ju vazhdoni të keni qasje të gabuar për sindikatat dhe tentoni të ndikoni në zgjedhjen e udhëheqjes në SBASHK dhe në Federatën e Sindikatës së Shëndetësisë, kryetari i ETUCE, Larry Flanagan, drejtoresha evropiane e ETUCE-së, Susan Flocken dhe sekretari i përgjithshëm i EPSU, Jan Willem Goudriaan, kanë shprehur pakënaqësinë e tyre duke i dërguar letër komisionarit të Bashkimit Evropian për Punë dhe Drejtësi Sociale, Nicolas Schmit, që ai të ngrit këtë çështje dhe të marrë hapa konkretë bazuar në

kompetencat që ka", thuhet në letër të SBASHK-ut.

Më tej thuhet se SBASHK-u ia rikujton kryeministrit Kurti se qasja e tij ndaj sindikatave dhe tendenca që të ndikojë se kush duhet e kush jo t'i udhëheqë ato është e gabuar. "I nderuar kryeministër Kurti, po jua kujtoj edhe një herë se qasja juaj ndaj sindikatave dhe tendenca që të ndikosh se kush duhet e kush jo t'i udhëheqë ato është e gabuar. Nuk qëndron vlerësimi juaj dhe për këtë nuk keni as edhe një argument, kur u paske deklaruar me shkrim zotërinjve Flanagan e Gourdiaan dhe znj. Flocken se deklaratat tuaja për ndryshime në drejtimin e sindikatave nuk duhet të perceptohen në asnjë mënyrë si kërcënim ndaj pavarësisë së atyre sindikatave. U paske shkruar edhe se këta të fundit mund dhe duhet ta zgjedhin gjithmonë udhëheqjen e tyre në zgjedhje të lira, të ndershme dhe transparente. Por se drejtuesit aktualë të këtyre sindikatave nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë demokratik të anëtarëve të tyre, përkundrazi, ato u instaluan nga qeveritë e korruptuara, neoliberalë të së kaluarës", theksohet në letër publike të SBASHK-ut drejtuar kryeministrit Kurti.

Miratohet Projektligji për Inspektimet, opozita e kundërshton



PRISHTINË, 23 DHJETOR - Me 67 vota për, 10 kundër dhe asnjë abstenim, deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë miratuar Projektligjin për Inspektimet.

Nga komisioni funksional janë paraparë 29 amendamente, të cilat u votuan një për një. Këtë projektligji e paraqiti deputetja e LV-së, Jeta Statovci. Ajo ka thënë se një

praktikë e tillë e inspektimit është në shumë shtete të botës.

Deputetja Jeta Statovci ka thënë se Projektligji për Inspektimet është hartuar nga Ministria e Tregtisë dhe është aprovuar nga qeveria. Sipas saj, qëllimi është t'i përcaktojë parimet e inspektimit, rregullat për rregullimin e veprimtarive të inspektimit dhe procedurat e

inspektimit. "Komisioni për Ekonomi, në bazë të vendimit të Kuvendit, e ka shqyrtuar këtë projektligji dhe ka hartuar edhe 29 amendamente. Komisioni rekomandon të miratohet Projektligji për Inspektimet. Është e nevojshme për koordinim inspektues. Hartimi i këtij ligji është praktikë në shumë shtete", ka thënë ajo.

Antigona Berisha-Bytyqi zgjedhet kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit

PRIZREN, 23 DHJETOR (ER) - Të enjten është mbajtur seanca e Kuvendit Komunal të Prizrenit. Në rend të dite ishte zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit Komunal.

Dy grupet më të mëdha parlamentare propozuan dy kandidatë.

Grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar për kryesues Adem Shabanaj,

kurse grupi i Partisë Demokratike të Kosovës ka propozuar për kryesuese Antigona Berisha-Bytyqi. Në një votim të rregullt, sipas procedurave të paracaktuara me ligj, me 35 anëtarë të kuvendit të pranishëm, pasi që kuvendarët e Lidhjes Demokratike të Kosovës lëshuan sallën e kuvendit, u votua Antigona Berisha-Bytyqi

kryesuese e Kuvendit Komunal të Prizrenit.

Në këtë mbledhje të Kuvendit Antigona Berisha-Bytyqi mori 21 vota, Adem Shabanaj 11 vota dhe 3 vota ishin të pavlefshme.

Antigona Berisha Bytyqi është zgjedhur kuvendare për dy mandate dhe tani do ta ushtrojë detyrën e kryesueses së Kuvendit Komunal të Prizrenit.



Reforma në fiskalizim e propozuar nga Ministria e Financave mund ta kthejë gjithë procesin në pikën zero

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Procesi i fiskalizimit, i nisur një dekadë më parë, jo rrallëherë është përballur edhe me sfida. Vënia nën kontroll fiskale e bizneseve në vend ka sjellë një qëndrueshmëri financiare për Kosovën falë edhe përkushtimit dhe qëndrueshmërisë së operimit të të gjitha palëve të përfshira. Megjithatë, shumë herë bizneset kanë arritur ta evitojnë fiskalizimin falë edhe hapësirave ligjore dhe mungesës së kontrollit në terren.

Disa nga sfidat e vazhdueshme që ky proces të përmbillet suksesshëm kanë qenë edhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin në fuqi dhe në

normat e vendosura nga institucionet e vendit përkitazi me fiskalizimin.

Në shumë tryeza, aktorë të ekonomisë kanë thënë se shpeshherë reformat fiskale që janë vendosur nga institucionet përkatëse nuk kanë qenë të mirëmbledhura dhe për më tepër e kanë kthyer nga e para gjithë këtë proces.

Për Odat Ekonomike ndryshimet e shpeshta në legjislacionin fiskal në disa raste edhe e kanë penguar zhvillimin e këtyre bizneseve për faktin se atyre u është dashur që në vazhdimësi të adoptojnë rregulla dhe kosto të reja.

Edhe për operatorët ekzistues në

shitjen dhe mirëmbajtjen e arkave fiskale, reformat fiskale kanë sjellë pengesa, të cilat domosdo janë transmetuar edhe te bizneset.

Për Edip Gashin nga kompania "Enternet" një nga pesë operatorët e licencuar për shitjen e arkave fiskale, ndryshimet e shpeshta në ligjet dhe rregulloret e punës sa i përket fiskalizimit, më së shumti kanë ndikuar për të keq te bizneset. "Nëse një biznes deri tani ka punuar me një pajisje, një tarifë apo një rregull ligjore, ai është mësuar me të dhe kësaj e aplikon suksesshëm në punën ditore. Çdo ndryshim atyre u shkakton humbje kohe dhe humbje monetare e

shpeshherë i detyron të punojnë 'në të zezën', ka shtuar Gashi. Sipas Gashit, udhëzimi i ri administrativ i iniciuar nga Ministria e Financave mund të sjellë përmbyse të sistemit të tanishëm jo vetëm për operatorët, por edhe për bizneset e, mbi të gjitha, për Administratën Tatimore së cilës i ngarkohet një tjetër detyrë, ajo e kontrollit teknik dhe monitorimit, për të cilin obligim ky institucion nuk ka kapacitete njerëzore. "Ne si kompani kemi përcjellë këto komente të Ministria e Financave dhe komisioni përkatës. Përveç mundësisë që procesi të mos mund të kontrollohet nga vetë ATK, është edhe një tjetër sfida,

ajo se sa mund të funksionojnë operatorët me këto rregulla. Nëse këta të fundit nuk arrijnë të përshtaten, procesi i fiskalizimit do të mund të bie në pikën zero, e kjo më së shumti mund të ndikojë te bizneset dhe në buxhetin e shtetit", ka shtuar Edip Gashi.

Ai ka sqaruar se tani është më lirë pasi kompania "Enternet" ka ofruar çmimet më të lira në treg për arkë fiskale me të gjitha shërbimet përcjellëse, duke nisur nga 9.99 euro në muaj dhe, gjithashtu, për klientët e kahershëm ka zbritur çmimin në vetëm 50 euro (+TVSh) për shërbimin e kontrollit të rregullit teknik dhe abonimit vjetor.



ZKA-ja gjen projekte në komuna që kanë filluar në vitin 2013 dhe s'kanë përfunduar ende

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Instituti GAP ka publikuar raportin "Sfidat e komunave në menaxhimin e investimeve, shpenzimeve, të hyrave dhe pronave".


Raporti analizon gjetjet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) sa iu përket investimeve publike që bëjnë komunat dhe problemeve që dalin në këtë drejtim sikurse pamundësia e komunave për të realizuar investime të qëndrueshme, ekonomikisht të favorshme dhe të përfunduara me kohë.

Në raportet vjetore të rregullësisë të ZKA-së shpërfaqen shumë sfida që komunat kanë në procesin e investimeve publike, në shpenzimin e buxhetit, në alokimin e të hyrave vetjake dhe

në menaxhimin e pronave publike.

Një nga problemet më të mëdha është pamundësia e komunave për t'i realizuar investimet brenda kohës së paraparë. Në 25 projekte të audituara për kohëzgjatjen e investimeve, ZKA ka gjetur se asnjë nga to nuk ka arritur të përmbillet brenda kohës së paraparë. Madje ka projekte që kanë nisur në vitin 2013 dhe të cilat nuk kanë përfunduar deri në fund të vitit 2020.

Sfidë tjetër e cila dëmton performancën e komunave është rritja e obligimeve të paguara dhe atyre kontingjente të komunave të cilat kanë shënuar rritje nga viti në vit. Kjo rrezikon edhe qëndrueshmërinë financiare të komunave. Deri në fund të vitit 2020 vlera e obligimeve kontingjente që kanë komunat



është 91 milionë euro, ndërsa vlera e obligimeve të paguara është 34 milionë euro.

Komunat i kanë këto obligime ndaj operatorëve ekonomikë dhe personave fizikë. Këto subjekte u drejtohen gjykatave dhe

përmbuesve që t'i marrin mjetet e tyre.

Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Thesari i Kosovës, bazuar në vendimet e gjykatave dhe përmbuesve, i ka marrë nga buxheti i komunave mbi 18 milionë euro.

Gjatë këtij procesi komunat kanë paguar shpenzime për gjykata dhe përmbues mbi 2.1 milionë euro. Sipas këtij raporti, komunat ballafaqohen edhe me sfida të tjera si ajo e realizimit të të hyrave vetjake. Brenda një viti komunat realizojnë të hyra vetjake rreth 79 milionë euro, ndërsa të hyrat që nuk kanë arritur t'i mbledhin komunat deri në vitin 2020 janë mbi 204 milionë euro. Përveç kësaj, komunat bëjnë edhe shkelje të cilat e dëmtojnë buxhetin publik. Këto shkelje lidhen me shfrytëzimin e pronave publike pa kontrata në mes të shfrytëzuesve dhe komunës, veprime të komunës për kompensim të shfrytëzuesve të pronave me mjete financiare e deri te shfrytëzimi i hapësirave publike si banesa e lokale me kompensim tepër të vogël.

Emanuel Makron dhe rënia e Francës në skenën botërore



Nga Martin Jay "TRT World"

Pas poshtërimit gjatë një përplasjeje të ashpër me Britaninë, dhe tërheqjes në momentin e fundit, presidenti i Francës, Emanuel Makron, do të përpiqet tani të rizgjidhet për një mandat tjetër në detyrë në zgjedhjet e pranverës së vitit të ardhshëm.

Kërcënimi absurd i Makron për të bllokuar hyrjen e kamionëve britanikë nga portet franceze, nëse Londra nuk plotëson kushtet e tij mbi një mosmarrëveshje në lidhje me zonat e peshkimit, krijoi një moment kritik, ku Makron e kuptoi se nuk kishte jo vetë mbështetjen e francezëve, por edhe atë të BE-së, dhe se Britania ishte e gatshme të përdorte Holandën si një alternativë për zbarkimin e kamionëve të saj në pjesën kontinentale të Evropës.

Sjellja agresive e Makron do të zemëronte jo vetëm Brukselin, por do ta bënte atë të dukej si një budalla përballë biznesit francez, që po dëmtohej gjithnjë e më shumë nga bojkoti që po i bënte Mbretëria e Bashkuar mallrave franceze

nëpër supermarkete.

Për më tepër në rastin e kërcënimeve të Makron, ai nuk ishte në gjendje të tërhiqej shpejt nga bllofi që po luante, dhe kjo qasje po dërgon sinjale shqetësuese në Bruksel, se ai është jashtë kontrollit dhe po e kërcënon projektin evropian. Fakti që shtetet e tjera anëtare janë të gatshme të shohin përpara dhe të bashkëpunojnë me Britaninë si një partnere tregtare fqinje e mirëpritur, e bën BE-në të duket e përçarë dhe praktikisht një projekt të dështuar. Por elita e BE-së në Bruksel, e ka një problem real me Makron.

Ai bëri lëvizjen e tij të fortë në fund të tetorit, duke sekuestruar një anije peshkimi britanike, në një përpjekje për të fituar vota në vend. Por krerët e komisionit të BE-së nuk janë të lumtur me lojërat e Makron, i cili luan rolin e liderit jozyrtar të unionit, me fjalimet dhe vizionin e tij mbi të ardhmen e BE-së.

Po Makron ka çuar shumë larg me këtë sjellje, duke e kaluar kufirin e besueshmërisë dhe shumë zyrtarë të BE-së shqetësohen se përplasjet e tij me Britaninë tani pas Brexit, po i bëjnë më shumë dëm sesa

mirë besueshmërisë së projektit evropian.

Duke e demaskuar bllofin e tij, Boris Xhonson i shkaktoi të goditje të fortë Makron dhe fushatës së tij presidenciale. Në sytë e shumë francezëve, ai u duk i dobët dhe budalla. Shtypi francez e masakroi me komente, ndërsa kundërshtarët e tij ishin të lumtur të jepnin intervista për gazetatat britanike.

Por sa dëm i ka bërë ai fushatës së tij? Disa analistë thonë se ka humbur shumë vota, pasi bllofi dështoi. Të tjerë që analizojnë gjendjen e përgjithshme të ekonomisë franceze, fajësojnë për situatën fanatikët pro-BE si Emanuel Makron.

Industria franceze nuk është më konkurruese, dhe ekonomia po vuan. Disa ekonomistë pretendojnë se qenia në eurozonë nuk po e ndihmon aspak Francën. Rritja e dobët ekonomike, taksat e larta, investimet e huaja të dobëta, dhe një ndjenjë e përgjithshme se Franca është mënjanuar nga disa prej marrëveshjeve të mëdha që ndodhin në mbarë botën, janë të gjitha së bashku një simptomë e përgjithshme e rënies së peshës së këtij vendi

në arenën ndërkombëtare.

Tek e fundit, kush mund t'i fajësojë australianët që nuk blenë nëndetëset e vjetruara franceze me motorë naftë? Edhe në Afrikë, ku prania e Francës nënvizohet gjithmonë nga ata që dëshirojnë ta mbrojnë nga kritikët, ku vend po humbet ndikimin dhe bizneset që ka atje.

Në Mali, politika aktuale e Francës është të apelojë ndaj OKB-së për ta ndihmuar në ruajtjen e rendit, në mënyrë të mund të vijnë aktivitetin kompanitë franceze, dhe qytetarët francezë të kenë një masë të caktuar mbrojtjeje kundër militantëve islamikë.

Në Afrikën e Veriut, ku Franca kishte një ndikim real për shkak të kolonizimit, e ka humbur gjatë presidencës Makron si Marokun ashtu edhe Algjerinë, si partnerë kryesorë në mosmarrëveshjet e fundit. Kërcënimi për të bllokuar kamionët britanikë që hyjnë në Francë ishte si një fitil i ndezur në erë.

Makron është në panik, pasi po nis të ndihet nisja e një vale të re protestash në Francë për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike, dhe ndikimit në rënie të vendit në mbarë botën.

Makron nuk ka një formulë magjike për ta përshpejtuar rritjen ekonomike, dhe njerëzit janë të lodhur nga euro-retorika e tij që dikur botohej edhe në gazetatat britanike.

Refuzimi nga Komisioni Evropian për të mbështetur planin e tij të keq-konceptuar për t'i "dhënë Britanisë së Madhe një leksion mbi Brexit", ishte një shenjë se Makron nuk gëzon më mbështetjen e palëkundur të Brukselit.

Problemi për ata që drejtojnë organet kryesore të BE-së si Ursula Von Der Lejen, një shtetase gjermane, është se shumë prej tyre janë të vetëdijshëm se me largimin e Angela Merkel nga drejtimi i qeverisë gjermane, Makron do ta shohë tani veten si udhëheqësin e projektit evropian.

Në rast se ai nuk do të arrijë të fitojë një mandat të dytë si president, ironia është se do të kërkojë nga BE një post të lartë si një lloj shpëtimi. Pasi kjo është mjerisht mënyra se si e konsiderojnë projektin shumë liderë të BE-së, jo shumë ndryshe nga një lloj skeme pensioni, të cilët ata e përfitojnë duke ruajtur ndikimin e tyre politik. /bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

EJU: Nora në Tokio arriti potencialin për t'u bërë kampione olimpike

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Federata Evropiane e Xhudos (EJU) e ka lartësuar kampionen olimpikë nga Kosova, Nora Gjakova, duke theksuar se 29-vjeçarja e arriti potencialin e plotë kur e fitoi medaljen e artë olimpikë në xhudo në Tokio 2020 verën e këtij viti. Në një shkrim për Gjakovën në uebsajtin e vet, EJU nënvizoi: "Kjo kampione olimpikë kishte një dekadë që po zhvillohej. Nora Gjakova ka qenë bindshëm në radarin tonë për shumë vjet si pjesë e një ekipi të vogël, por madhështor të Kosovës. Jo vetëm që e fitoi medaljen e parë botërore, por 29-vjeçarja mbizotëroi ndaj kundërshtareve për ta fituar të artën olimpikë". "Suksesi i jashtëzakonshëm ia ka mundësuar asaj të ngrihet në renditje dhe ta përfundojë vitin në vendin e parë në renditjen botërore. Ajo i bashkohet shoqes së ekipit, Distria Krasniqi, si atletja numër një", ka shkruar

tutje shtëpia evropiane e xhudos. Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi e mbyllën vitin 2021 në vendin e parë në kategoritë e tyre përkatëse në renditjen botërore të xhudos ditë më parë. Gjakova e zuri vendin e parë në ranglistën botërore të xhudos në kategorinë -57 kilogramë për herë të parë në karrierën e saj. 29-vjeçarja i mblodhi 5 880 pikë në vendin e parë, duke e kaluar xhudisten kanadeze Jessica Klimkait, e cila tani ngel e dyta me 5 830 pikë. Distria Krasniqi e ka ruajtur pozitën e parë në kategorinë e vet -48 kilogramë, në të cilën nuk do të bëjë më gara nga viti i ardhshëm, pasi ka kaluar një kategori më lart, atë -52 kilogramë. 26-vjeçarja i ka 5 920 pikë në vendin e parë, duke e lënë mbrapa mongolen Urantsetseg Munkhbat, e cila mbledh 5 250 pikë. Gjakova dhe Krasniqi përjetuan vitin më të mirë gjatë 2021-s në karrierat e



tyre të shquara, duke i shpallur kampione olimpikë në kategoritë e tyre përkatëse në Lojërat Olimpikë Verore në Tokio. Ato i ndoqën hapat e legjendës

dhe xhudistes nga e cila u frymëzuan, Majlinda Kelmendi, duke fituar medalje të arta në Japoni dhe falë tyre Kosova tani ka tri medalje të arta olimpikë.

Krasniqi u shpallë xhudistja më e mirë e vitit në botë së fundi nga votat e publikut në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos.

Përzgjedhësi Qerimi zbardh listën për ndeshjet e janarit

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Përzgjedhësi i Kosovës në hendboll, Bujar Qerimi, e ka shpallur listën e lojtarëve për ndeshjet kualifikuese për Botërorin 2023. Kosova më 5 janar luan në Prishtinë me Greqinë, kurse ndeshja e dytë ndaj grekëve zhvillohet më 9 janar në Kretë. Më pas "dardanët" përballen me Turqinë më 12 janar në Prishtinë, ndërsa cikli kualifikues përmbyllet me ndeshjen Belgjika - Kosova, që është më 15 janar. Kosova tashmë ka luajtur dy ndeshje, me Turqinë dhe Belgjikën, ndërsa e ka një pikë, sa edhe Belgjika. Kosova synon njërin prej dy vendeve të para në grup, që siguron avancimin në fazën e dytë kualifikuese. Përzgjedhësi Qerimi për ndeshjet e janarit llogarit në 21 lojtarë. Por fillimisht Kosova luan miqësore me Malin e Zi të dielën në Podgoricë. "Dardanët"



LISTA E LOJTARËVE

Agon Bajqinovci, Kastriot Jupa, Valon Dedaj, Drenit Tahirukaj, Deniz Terziqi, Arti Luzha, Arbios Mushkolaj, Luigj Quni, Festim Mustafa, Drlon Tahirukaj, Lulëzim Shabani, Haris Berisha, Florian Rexha, Mursel Mehmeti, Bujar Ramosaj, Jon Muqolli, Leonard Gegaj, Salih Maxhera, Egzon Gjuka, Liridon Zena, Shaban Zogaj.

grumbullohen të premten në "Hotel Internacional" në Prishtinë. Grumbullimi i lojtarëve bëhet prej orës 11:00 deri në orën 12:00. Stërvitja e parë është nga ora 15:30 në Pallatin e Rinisë. Stërvitje tjetër

Kosova mban të shtunën prej orës 9:30, kurse pas drekës është udhëtimi për në Podgoricë. Prej 27 deri më 30 dhjetor, Kosova sërish ushtron në Prishtinë, ndërsa më pas stërvitjet rifillojnë më 2 janar.

Kosova mbylli vitin në vendin e 111-të, Shqipëria e 66-ta

PRISHTINË, 23 DHJETOR - FIFA ka publikuar të enjten renditjen e re të kombëtareve, të fundit për vitin 2021. Përfaqësuesja e Kosovës pozicionohet në vendin e 111-të në renditjen botërore, duke mos ndryshuar asnjë pozicion. Ndeshja e fundit e "dardanëve" për këtë vit ishte ajo ndaj Greqisë në Athinë, të cilët barazuan me rezultatin 1-1. Në shtator të këtij viti Kosova e kishte shënuar ngritjen më të lartë në historinë

e ekipit kombëtar në renditjen e FIFA-s, duke e zënë vendin e 109. Ndryshe, Kosova ngritjen më të madhe e kishte përjetuar në muajin shtator të këtij viti, duke u renditur në vendin e 109. Në anën tjetër, Shqipëria e mbylli vitin 2021 në pozitën e 66. Kombëtarja shqiptare ka mbledhur gjithsej 1374.98 pikë deri tani. Belgjika e ka mbyllur për të katërtin vit në vendin e parë, ndërsa pas saj në 'top 10' renditi Brazili i dyti, Franca e treta, Anglia e katërta dhe Argjentina e pesta. Italia e mbylli vitin në vendin e gjashtë, Spanja në të shtatin, Portugalia në të tetin, Danimarka e nënta dhe Holanda e dhjeta.



West Hami planifikon rikthimin e Januzajt në Angli

LONDËR, 23 DHJETOR - Adnan Januzaj ka refuzuar rinovimin me Real Sociedadin, teksa nga një janari është i lirë të zgjedhë vetë të ardhmen. Sipas medieve britanike, dëshira e

ish-fantazistit të Manchester Unitedit është që të rikthehet në Premier Ligë dhe ka pasur negociata paraprake me londinezët e West Hamit. Interesim për 26-vjeçarin ka

treguar edhe Barcelona, e cila po kalon nëpër një krizë financiare. Transferimi i Januzajt mund të realizohet në "Camp Nou" me parametra zero dhe, gjithashtu, ka

aktualisht një pagë prej 1.8 milion eurosh në sezon, ndaj drejtuesit e Barcelonës mund ta joshin me një shifër jo më të lartë se 3 milionë eurot në vit.




Penza, kampione vjeshtore në Ligën Unike

Pejë, 23 dhjetor - Penza ka mundur Bashkimin me rezultat 77:57 (13:9, 23:13, 21:13, 20:22), në xhiron e pestë të Ligës Unike në konkurrencën e femrave, që ishte xhironja e fundit për stinorin vjeshtor. Penza shpallet kampione vjeshtore, pasi në pesë ndeshje ka shënuar pesë fitore,

duke qenë skuadra e vetme pa humbje, ndërsa Bashkimi ka dy fitore dhe tri humbje. Çereku i parë ishte kryesisht i barabartë, por në fund vendaset me tri pikë e fituan këtë pjesë 13:9. Kampionet e Kosovës ishin më të mira nga periudha e dytë, ku ngritën epërsinë deri në 15 pikë,

34:19, ndërsa pjesa e parë përfundon me shifrat 36:22. Vashat pejane vazhduan me lojë të mirë në periodën e tretë, për t'u mos u ndalur dhe rritur epërsinë, ku më e larta shkoi deri në 22 pikë, 57:35, sa ishte rezultati pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit Penza

menaxhoi lojën dhe ruajti epërsinë për të triumfuar me shifrat 77:57. Te Penza u dalluan Valbona Bytyqi me 24 pikë, Rael Whitsitt me 20 pikë e 19 pikë dhe Jeta Zeka me 15 pikë, kurse te Bashkimi u dalluan Christina Ellis me 17 pikë dhe Era Shatri me 16 pikë e dhjetë kërcime.



U mbajt Konferenca e Tretë Ndërkombëtare Shkencore për Edukimin Fizik, Sportin dhe Shëndetin

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Është mbyllur të enjten Konferenca e 3-të Ndërkombëtare Shkencore për Edukimin Fizik, Sportin dhe Shëndetin e cila është organizuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës (UP), konkretisht Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS), Universitetin e Tiranës (UT) dhe Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH).

Konferenca dyditore mbledhi profesorë dhe studiues të shumë vendorë dhe ndërkombëtarë të cilët paraqitën punimet e tyre shkencore nga fusha e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit. Në fjalën hapëse, presidenti i KOK-it, Ismet Krasniqi, ka theksuar se KOK-u synon që përmes bashkëpunimit me institucionet arsimore dhe sportive në vend, të kontribuojë në avancimin e edukimit dhe kërkimeve shkencore në sport, derisa përmendi memorandumit e bashkëpunimit me UP-në, themelimin e Akademisë Olimpikë, derisa veçoi suksesin e Kosovës të arritur në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". "Sukseset e tilla duhet t'i motivojnë të gjithë pjesëmarrësit në këtë konferencë,



por edhe hulumtuesit e tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë, që nëpërmjet kërkimit shkencor të dalin me konkluzione të cilat avancojnë nivelin e sportit, sportistëve dhe Lëvizjes Olimpikë në vendin tonë", ka thënë i pari i KOK-it.

Të pranishmëve iu drejtua edhe presidenti i KOKSh-it, Fidel Ylli, i cili duke çmuar lart organizimin e përbashkët të kësaj konference, theksoi se njohja më e madhe e Kosovës i është bërë përmes sportit, konkretisht parakalimit në Lojërat Olimpikë "Rio 2016" dhe medaljes së Majlinda Kelmendit. Për rëndësinë e madhe që ka kjo konferencë folën edhe rektori i

Universitetit të Prishtinës, Naser Sahiti, rektori i Universitetit të Tiranës, Agron Kasa, dekani i FEFS-it, Musa Selimi, si dhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. Konferencën e madhështoi edhe më shumë prania e kampioneve olimpikë, Distria Krasniqi e Nora Gjakova, dhe trajneri më i mirë për vitin 2021 në botë për sportin e xhudos, Driton Kuka, të cilët patën edhe një fjalë rasti, ku vlerësuan lart organizimin e kësaj konference. Qëllimi i konferencës ishte nxjerrja e konkluzioneve të cilat avancojnë nivelin e sportit, sportistëve dhe Lëvizjes Olimpikë në vendin tonë.

Milwaukee rikthehet te fitorja

MILWAUKEE, 23 DHJETOR - Skuadra kampione e Milwaukeees rikthehet te fitorja, duke mundur me rezultat 126-106 Houstonin, ndeshje e



Middletoni me 23 pikë ishin më të mirët në fushë. Fiton edhe skuadra e Orlandos, që mundi me rezultat 104-98 Atlantian, ndeshje me rivalitet shumicën e kohës. U dallua Wagneri, autor i 25 pikëve. Nuk zhgënjën ekipi i clippersave që falë 19 pikëve të Bledsoes

dominuar nga Bucks. Holiday me 24 pikë e 10 asistime si dhe

mundi me rezultat 105-89 Sacramenton.

NBA

Atlanta - Orlando	98-104
Boston - Cleveland	111-101
Milwaukee - Houston	126-106
Oklahoma - Denver	108-94
Sacramento - Clippers	89-105

SHKURT

Dembele javën e ardhshme rinovon kontratën me Barçën

Skuadra e Barcelonës gjatë javës së ardhshme pritet që të bëjë zyrtare rinovimin e kontratës me sulmuesin francez Ousmane Dembele. Francezi është pjesë kyçe e formacionit bazë të Xavit dhe ka vendosur t'i mbetet besnik skuadrës katalunase. Gazetari Zherard Romero ka zbuluar se Barcelona synon ta komplettojë rinovimin e futbollistit gjatë verës tjetër. Sipas tij, ishte Dembele që kishte kërkuar nga agjenti duke i thënë "negocio për të rinovuar". Ndërkohë, Manchester Unitedi, Liverpooli dhe Juventusit ishin në garë për transferimin e Dembeles.

Pjaniqi refuzon ofertën e Genoas

Miralem Pjaniqi nuk u la kohë as të ëndërronin tifozët e Genovas. Menjëherë pas thashethemeve për interesimin e Griffinit për ish-mesfushorin e Juventusit, menjëherë nga Turqia ka ardhur përgënjeshtimi i të interesuarit. "Te Beshiktashi jam mirë dhe i lumtur", ka thënë për medie të Stambollit. "Unë kam luajtur pak deri tani sepse kam qenë i lënduar për një kohë të gjatë, por tani jam kthyer dhe kam ndërmend të qëndroj këtu deri në fund të sezonit", ka përfunduar mesfushori boshnjaku.

Pavardi, në mes të Realit dhe Atletico

Pas një viti jashtëzakonisht të mirë në Bayern Munchenin, Benjamin Pavard nuk është më i paprekshëm te Bayerni. Ardha e trajnerit të ri Julian Nagelsmann ka bërë që mbrojtësi francez mos ta ketë të sigurt vendin në formacionin bazë. Këtë edicion mbrojtësi francez ka pasur ulje e ngritje të formës dhe nuk është më i paprekshëm në kampin "bavarez". Sipas asaj që ka raportuar televizioni gjerman "Sport 1", Pavard është në agjendën e dy skuadrave spanjolle, Real Madridi dhe Atletico Madridi. 25-vjeçari dëshiron që të luajë rregullisht për ta ruajtur vendin në kombëtaren franceze dhe nëse vazhdon të mos luajë çdo ndeshje do ta kërkojë largimin nga "Allianz Arena". Pavardi ka një kontratë me Bayernin deri në verën e vitit 2024, derisa ai vlerësohet rreth 40 milionë euro nga gjiganti gjerman.

Katër futbollistë të Realit shërohen nga Covid-19

Real Madridi ishte pa disa nga yjet kryesorë të skuadrës në takimin ndaj Athletic Clubit shkaku që ishin pozitivë me Covid-19. Plot 12 futbollistë të Realit munguan shkaku që ishin pozitivë me Covid-19, ose kishin simptoma. Mirëpo, tani "Los Blancos" ka marrë lajme të mira, pasi katër yje veçse kanë dalë negativë në analizat e fundit. Luka Modriq, David Alaba, Gareth Bale dhe Rodrygo janë futbollistët që kanë testuar negativë në analizat e mëngjesit. Ndërkohë, Real Madridi e mbylli me fitore këtë vit, duke triumfuar ndaj Bilbaos me rezultat të ngushtë 1-2.

Bayerni e sheh Chiesan si zëvendësues i Comanit

Anëtori Kingsley Coman mund të largohet nga Bayern Muncheni. Skuadra gjermane nuk dëshiron të humbasë kohë dhe po mendon që tani për

zëvendësuesin e tij. I pari në listë është kampioni i Evropës me Italinë dhe ylli i Juventusit, Federico Chiesa. Anëtori i majtë shihet si lojtari i vetëm që mund ta

plotësojë boshllëkun që do ta lërë Comanin. Kualitetet e italianit nuk kanë kaluar pa u vënë re nga "bavarezët" që edhe më herët kanë shfaqur interes për të. Karl-Heinz

Rummenigge është shprehur se pëlqente shumë stilin e lojës së 24-vjeçarit i cili në "Transfermarkt" vlerësohet 70 milionë euro. Por, ashtu siç pretendon

Bayerni për Comanin, edhe bardhezinjtë nuk do ta lejojnë Chiesan të largohet pa 90-100 milionë euro, para që gjermanët i kanë nëse do ta shisnin francezin.

Në bazë të Ligjit për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087 nenit 17 dhe 21 si dhe Ligjit Nr. 04/L-111 për plotësim ndryshimin e Ligjit për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087, Nenit 9 dhe 13 me të cilat nene, plotësohen dhe riformulohen Nenit 17 dhe 21 të Ligjit bazik, Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Ligjit Nr. 06/L-021., Për Kontrollin e brendshëm të financave publike Nr.06/L-021 nenit 22 si dhe vendimit të Komisionit për Auditim të TK Sh.A., nr. 6 me nr. Protokolli 01-3712/21 të datës 01.11.2021, Komisioni për Auditim të TK Sh.A., shpall këtë:

KONKURS PËR VEND TË PUNËS

Titulli i punës: **Zyrtar/e për Auditim të Brendshëm**
 Raporton: Komisionit për Auditim të TK sh.a.
 Grada: G-17
 Mandati: 3 (tre) vite
 Vendi: Prishtinë
 Ndërmarrja: Telekom i Kosovës Sh. A

Nr. i Referencës: 01-3712/21

Afati i fundit për aplikim : 10.01.2022

PËRSHKRIMI I NDËRMARRJES

Telekomi i Kosovës Sh. A (TK) është ndërmarrje publike e licencuar për ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të telekomunikacionit në një treg të hapur duke sjellë inovacione dhe risi në tregun e telekomunikacionit. TK është në kërkim të: **Zyrtar për Auditim të Brendshëm** me kualifikim, integritet të njohur dhe përvojë të nevojshme profesionale që do të udhëheqë Departamentin e Auditimit të Brendshëm në përputhje me parimet e njohura për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike.

Titulli i punës: **Zyrtar për Auditim të Brendshëm**

Duke i raportuar Komisionit të Auditimit të TK sh.a., Zyrtari për Auditim të Brendshëm është përgjegjës për vlerësimin e përshtatshmërisë ligjore dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme në përputhje me planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm në TK sh.a..

Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat kryesore për Zyrtarin e auditimit të brendshëm janë:

- Të rrisë dhe mbroj vlerën e organizatës duke ofruar siguri dhe integritet përmes auditimit dhe këshillëdhënies të bazuar në rrezik dhe objektivë.
- Të menaxhoj dhe organizoj funksionin e Auditimit të Brendshëm të NP Telekom i Kosovës sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (IIA).
- Të hartojë Politikën e Auditimit të Brendshëm, në përputhje me Misionin e Auditimit të Brendshëm dhe elementët e detyrueshëm të Kuadrit të Praktikave Profesionale Ndërkombëtare (Parimet Thelbësore të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, Kodit të Etikës, Standardeve dhe Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm). Auditori i Brendshëm duhet të rishikojë periodikisht statutin e auditimit të brendshëm dhe ta paraqesë atë për miratim të Komisionit të Auditimit.
- Të hartoj dhe propozoj planin strategjik dhe vjetor të Auditimit të Brendshëm të TK-së për shqyrtim dhe miratim nga Komisioni i Auditimit .
- Të raportojë Komisionit të Auditimit të TK-së për procesin e auditimit sipas Planit të Auditimit.
- Planifikon proceset e auditimit përmes së cilave vlerësohen kontrollet e brendshme dhe performanca, në pajtueshmëri me standardet profesionale;
- Përgatit dhe ekzekuton programe auditimi për të kryer auditime sipas planit vjetor duke përcaktuar objektivat e auditimit, kriteret e auditimit dhe duke identifikuar rreziqet dhe kontrollet;
- Dizajnon procedura testimi me qëllim të vlerësimit të adekuatshëm të kontrolleve të brendshme për përmbushje të objektivave të auditimit;
- Siguron, analizon dhe vlerëson të dhënat mbështetëse (evidencat) përmes veglave të ndryshme ndihmëse;
- Përgatit raportet e auditimit që pasqyrojnë qartë objektivat e auditimit, fushëveprimin, gjetjet, rekomandimet, konkluzione;
- Kryen përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve të mëhershme ;
- Kryen Ad Hock auditime dhe detyra tjera me kërkesën e Komisionit të Auditimit TK-së;
- Siguron dokumentimin e letrave të punës sipas metodologjisë së aprovuar;
- Të ndihmoj në ruajtjen e kontrolleve efektive përmes: (i) Vlerësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të kontrolleve.(ii) Nxitjes së përmirësimit të vazhdueshëm të mjedisit të kontrollit dhe (iii) Identifikimit të mundësive për përmirësimin e aktivitetit të kontrollit.
- Ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e qeverisjes përmes: (i) Nxitjes së etikës dhe vlerave të përshtatshme. (ii) Ofrimit të siguri dhe integritetit të menaxhimit efikas të performancës dhe llogaridhënies. (iii) Komunikimit efektiv të informacionit të rrezikut dhe kontrollit. (iv) Koordinimit efektiv i aktiviteteve të siguri dhe integritetit.
- Të demonstroj integritet, kompetencë dhe kujdesin e duhur profesional. Të jetë objektiv dhe i pavarur, të përshtatet me strategjinë, objektivat dhe rreziqet e TK-së. Të jetë proaktiv dhe i fokusuar në të ardhmen që të rekomandoj dhe këshillojë përmirësimin e kontrollit të brendshëm të TK-së.

- Të promovojë kulturë etike në ushtrimin e profesionit të auditimit të brendshëm duke respektuar parimet fundamentale dhe rregullat e sjelljes të përcaktuara me Kodin e Etikës së Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (Parimet Fundamentale sipas Kodit të Etikës: Integriteti, Objektiviteti, Konfidencialiteti, Kompetenca).

Kushtet dhe kriteret që zyrtari i auditimit të brendshëm duhet t'i plotësoj:

- Të ketë diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet(diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHTI-t);
- Të ketë certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave (dëshmi);
- Të është anëtar aktiv në listën e njërës nga organizatat e akredituara në Kosovë (dëshmi);
- Të ketë vijuar Edukim të Vazhdueshëm Profesional, duke marrë pjesë në gjashtëdhjetë (60) orë trajnim brenda dy (2) viteve të njëpasnjëshme (2019/2020), në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr. 06/L-021 (dëshmi);
- Të përmbushë kriteret për zyrtarë të ndërmarrjes sipas nenit 9 dhe 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Ndërmarrjet Publike;
- Kandidati duhet të ketë përvojë në menaxhim financiar/auditim. Preferohen individët me përvojë pune në ndërmarrjet korporata tjera me madhësi dhe kompleksitet të lartë;
- Kandidati duhet të posedojë aftësi për kryerjen e një game të gjerë të aktiviteteve, përfshirë këtu vlerësimet e sistemit të kontrollit të brendshëm, analizën e informacioneve financiare dhe jo financiare, kontrollimin e aktiviteteve operacionale, zbulimin e gabimeve të mundshme brenda entitetit dhe gjithashtu ofrimin e sugjerimeve të nevojshme për përmirësim;
- Aftësi të forta bindëse/ndër personale;
- Zotësi për t'u përshtatur në situata të pa-planifikuara, apo të ndryshuar, fleksibilitet të planeve dhe masat për t'u përballur me rrethanat e tilla;
- Zotësi të delegimit dhe monitorimit të autoritetit dhe përgjegjësisë tek bashkëpunëtorët për kryerjen e funksioneve të deleguara;
- Pavarësia dhe niveli i lartë i integritetit përgjatë aktiviteteve në korporatë;
- Aftësi për udhëheqje për arritjen e objektivave të përgjithshme të TK Sh. A, si dhe aftësia për të marrë vendime të rëndësishme në situatat e vështira;
- Preferohet njohuri e mirë e gjuhës angleze në të shkruar dhe të folur.

Aplikacionet duhet të dërgohen të shkruara në njërin prej gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës dhe mund të merren online në www.kosovotelecom.com.

Kërkesa/aplikacioni për punësim se bashku me CV të detajuar, letër motivuese, dëshminë e kualifikimit, përvojës, certifikata nga gjykata kompetente për mosqenie nën hetime jo me e vjetër se 6 muaj dhe Deklaratën nën Betim të nënshkruar (të cilën mund ta merrni online në www.kosovotelecom.com), duhet të dorëzohen personalisht në zarf të mbyllur në zyrën e arkives qendrore kati VI, zyra nr.603. Ndërtesa Kryesore e TK Dardania pa nr. 10000 Prishtine, Republika e Kosovës.

Letër-Referencat nuk kërkohen të dorëzohen në këtë fazë.

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe jo adekuat do të refuzohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Kompania "Leo Tobacco" SHPK me seli në Prizren ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër të regjistrimit: 811442912 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore- Debitore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin 30-ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obaveštavamo sve klijente da Tvrtka " Leo Tobacco " DOO u Prizren doneo odluku da ugasi biznis po br.registra: 811442912 i ujedno imenovao Likfidatora o sprovođenju postuaka likfidacije. Obavestavaju se svi klijenti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the Company "Leo Tobacco" LLC in Prizren has come to the decision to quite its business with registry: 811442912. The company has appointed a liquidator who is going to Oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day to newspaper announcement publication.

Na osnovu Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, članovi 17. i 21. kao i Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, članovi 9 i 13, kojima se dopunjuju i reformulišu članovi 17 i 21 osnovnog zakona, Kodeksa etike i korporativnog upravljanja za javna preduzeća, Zakon br. 06/L-021 o internoj kontroli javnih finansija, član 22. kao i Odluke Komisije za reviziju, TK a.d. sa brojem protokola 01-3712/21 donetoj na sastanku Komisije za Reviziju br.6 dana 01.11.2021, Komisija za reviziju TK a.d. raspisuje:

KONKURS ZA RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: **Službenik/ca za unutrašnju reviziju**
Izveštava: Komisiji za reviziju TK a.d.
Stepen: G-17
Mandat: 3 (tri) godine
Radno mesto: Priština
Preduzeće: Telekom Kosova a.d.

Referentni Broj: 01-3712/21

Zadnji rok za prijavu: 10.01.2022

OPIS PREDUZEĆA

Telekom Kosova a.d. (TK) je javno preduzeće licencirano za pružanje telekomunikacionih usluga i proizvoda na otvorenom tržištu, donoseći inovacije i novine na tom tržištu. TK želi popuniti položaj **Službenika/ce za internu reviziju**, sa kvalifikacijom, poznatim integritetom i potrebnim stručnim iskustvom, kako bi rukovodio Departamentom za Unutrašnju reviziju u skladu sa poznatim načelima za korporativno upravljanje javnim preduzećima.

Naziv radnog mesta: Službenik/ca za Unutrašnju Reviziju

Uz podnošenje izveštaja Odboru direktora, službenik/ca za unutrašnju reviziju je odgovoran/a za procenu efikasnosti finansijskih dokumenata i njihovu usklađenost sa zakonima, u skladu sa Godišnjim planom revizije TK-a.

Glavni zadaci, odgovornosti i nadležnosti službenika/ce za unutrašnju reviziju su da:

- Poveća i zaštititi vrednost organizacije pružanjem sigurnosti putem revizije i saveta zasnovanim na riziku i cilju.
- Upravlja i organizuje funkciju interne revizije JP Telekom Kosova, prema Međunarodnim standardima interne revizije (IIA).
- Izrađuje politiku interne revizije, u skladu sa misijom Interne revizije i obaveznim elementima Međunarodnog okvira stručne prakse (Osnovni principi stručne prakse interne revizije, Kodeks etike, standardi i definicija interne revizije). Interni revizor treba da periodično pregleda statut interne revizije i da ga podnosi Komitetu za reviziju na odobrenje.
- Izrađuje i predlaže strateški i godišnji plan interne revizije TK-a za razmatranje i usvajanje od strane Komisije za reviziju.
- Izveštava Komisiju za reviziju TK-a o procesu revizije prema Planu revizije.
- Planira procese revizije kroz koje se procenjuju unutrašnje kontrole i radni učinak, u skladu sa profesionalnim standardima;
- Priprema i sprovodi programe revizije za primenu revizija u skladu sa godišnjim planom uz utvrđivanje ciljeva revizije, kriterijuma revizije i identifikovanje rizika i kontrola;
- Dizajnira postupak testiranja u cilju procene adekvatnosti unutrašnjih kontrola za ispunjavanje ciljeva revizije;
- Obezbeđuje, analizira i ocenjuje prateće podatke (dokaze) uz pomoć različitih sredstava;
- Priprema revizorske izveštaje koji jasno odražavaju ciljeve revizije, obim, nalaze, preporuke, zaključke;
- Prati sprovođenje prethodnih preporuka;
- Obavlja ad hok revizije i druge poslove na zahtev Komisije za reviziju TK-a;
- Obezbeđuje dokumentovanje radnih spisa po odobrenoj metodologiji;
- Pruža pomoć u održavanju efektivnih kontrola kroz: (i) procenu efektivnosti i efikasnosti kontrola (ii) promovisanje stalnog poboljšanja okruženja kontrole; i (iii) utvrđuje mogućnosti za poboljšanje aktivnosti kontrole.
- Pruža pomoć pri ocenjivanju i poboljšanju upravljanja kroz: (i) Promovisanje odgovarajuće etike i vrednosti. (ii) Obezbeđuje efikasno upravljanje radnim učinkom i odgovornošću. (iii) Efikasno saopštavanje informacije o riziku i kontroli. (iv) Efikasno koordinira aktivnosti bezbednosti.
- Treba da pokaže da poseduje integritet, sposobnost i odgovarajuću profesionalnu pažnju. Da bude objektivan i nezavisan, da se prilagodi strategiji, ciljevima i rizicima TK-a. Trba da bude proaktivan i usredsređen na budućnost, kako bi bio u stanju da preporučiti i savetuje poboljšanje interne kontrole TK-a.
- Promoviše kulturu etike u vršenju profesije interne revizije uz poštovanje osnovnih principa i pravila ponašanja utvrđenih u Kodeksu etike, međunarodnim standardima interne revizije (Osnovni principi Kodeksa etike: Integritet, Objektivnost, Poverljivost, Sposobnost .

Uslovi i kriterijumi koje službenik za internu reviziju treba da ispuni

- Da ima univerzitetsku diplomu iz ekonomije, prava, javne uprave, javnih finansija ili drugih oblasti studija koje su relevantne za sektor koji će biti predmet revizije (diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MPNTI-a);
- Da poseduje sertifikat internog revizora u javnom sektoru, izdatom od strane Ministarstva za finansije ili sertifikat za internog revizora u javnom sektoru izdatog od relevantne međunarodne ili domaće institucije u skladu sa kriterijumima koje izdaje ministar za finansije (dokaz);
- Da bude aktivan član u listi jedne od akreditovanih organizacija na Kosovu (dokaz);
- Da ima kontinuirano stručno obrazovanje, da je pohađao šezdeset (60) časova obuke u roku od dve (2) uzastopne godine (2019/2020), u skladu sa kriterijumima iz člana 25. Zakona o unutrašnjoj kontroli javnih finansija br. 06 / L-021 (dokaz);
- Da ispuni kriterijume za službenike kompanije, prema članovima 9 i 13, Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona o javnim preduzećima;
- Kandidat mora imati iskustva u finansijskom upravljanju ili reviziji. Poželjni su pojedinci sa radnim iskustvom u drugim velikim i složenim korporativnim preduzećima;
- Sposobnost delegiranja i praćenja ovlašćenja i odgovornosti saradnicima koji će obavljati delegirane funkcije;
- Nezavisnosti i integriteta pri obavljanju poslova u kompaniji.
- Sposobnost rukovođenja ka postizanju opštih ciljeva TK-a, kao i sposobnost donošenja važnih odluka u teškim situacijama;
- Preporučuje se dobro poznavanje engleskog jezika (pismeno i usmeno izražavanje).

Obrazac prijave na konkursu treba da se popuni na jednom od zvaničnih jezika koji se upotrebljavaju u Republici Kosova i mogu se preuzeti sa sledeće internet stranice www.kosovotelecom.com.

Prijavu i detaljnu poslovnu biografiju, motivaciono pismo, dokaze o stručnoj spremi i Uverenje, izdato od nadležnog suda (sa rokom važenja od 6 meseci), da se protiv kandidata ne vodi krivični postupak kao i potpisano pismenu Izjavu pod Zakletvom (koju mozete preuzeti sa internet stranice www.kosovotelecom.com), treba dostaviti lično u zatvorenoj koverti u kancelariji Glavne arhive (br. 6), sprat VI, Glavna zgrada TK-a, naselje Dardania, 10000 Priština, Republika Kosovo.

Pisma preporuka se ne zahtevaju u ovoj fazi postupka.

Kandidati/kinje koji/e podnesu nepotpunu ili neadekvatnu prijavu i dokumentaciju biće odbijeni.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Adnan Curri shpall te pavlefshme deftesen e Sh.F.M.U "Ilaz Thaqi" Hani Elezit.

► Bardha Bytyqi Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Vullnet Berisha Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X të SH.M. të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.

► Skyfer Haxhija Gjakovë, shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Sot më 24.12. 2021 behën 17 vjet pa më të dashurin tonë



Liridon (Sejdi) Dërmaku

(17.07.1983 - 24.12.2004)

Bir, vëlla e axhë kaluan 17 vjet që kur të vrau armiku, i cili ishte dhe është kundër bashkimit kombëtar. Ti pusho i qet në dheun e Shqiptarisë, sepse Shqipëria po bëhet e do të bëhet ashtu siç ti dhe luftëtarët e lirisë e latë amanet. Në çdo përvjetor tëndin na pyesin, nëse po mërzhitemi e po kemi mall për ty. Është e pamposhtur dhembja dhe i padurueshëm malli për ty, por krenaria që dhe jetën për jetët e shqiptarëve dhe Shqiptarisë na jep forcë që të vazhdojmë përpara. Ti je atje ku gjenden më të mirët e kombit, duke i bërë roje atdheut. Nderime Atdheut dhe lavdi ty dhe të gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë dhe bashkimin e shqiptarëve. Gjithmonë krenarë me ty!

Të kujtojnë dhe kurrë s'të harrojnë: Nëna Feridja, babai Sejdiu dhe e tërë familja Dërmaku nga Shipashnica e Epërme e Dardanës dhe Prishtina.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

